

## **V E N D I M**

**Nr.43, datë 21.1.1999**

### **PËR MBULIMIN E VLERËS SË MALLRAVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE TË VJEDHURA E TË GRABITURA NË DEPOT E DREJTORISË SË REZERVAVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

#### **V E N D O S I:**

1. Vlera e pajisjeve të televizionit “Euro Vefa”, të shoqërisë “Vefa Holding”, sh.p.k. në administrim për 400 000 (katërqind mijë) USD dhe vlera e pijeve alkoolike të shoqërisë “M.Leka” në administrim për shumën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) USD, sipas çmimit të vlerësimit të administratorëve të tyre, të mbajtura në ruajtje pranë depove të rezervave Shtetërore, në kundër, për llogari të shoqërive huamarrëse subjekte të kontrollit, të vjedhura e të grabitura në ngjarjet e muajit shtator 1998, t’u kthehet këtyre shoqërive për shlyerjen e kreditorëve.

2. Fondi në vlerë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga të ardhurat e planit financiar të vitit 1999 të Drejtorisë së Rezervave Shtetërore.

3. Ngarkohen Drejtoria e Rezervave Shtetërore dhe Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**